



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1577 / 5 Prot

Tiranë, më 6 / 12 / 2013

REKOMANDIM

Nr. 50 datë 06 / 12 / 2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “**Universiteti Metropolitan Tirana**”, **Tiranë**.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 226 datë 07.11.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Universiteti Metropolitan Tirana**”, me adresë, Rr. “Budi” dhe “Sotir Kolea”, Qyteti Studenti, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i formularit të njoftimit (neni 21);
- Informimi i subjekteve të të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale (neni 18 i ligjit);
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin që kontrolluesi “*Universiteti Metropolitan Tirana*”, mbledh dhe përpunon gjatë aktivitetit të tij.
- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësues të këtij kontrolluesi.
- Inspektoi ambientet, zyrat e sekretarisë, dhe arshivën e këtij kontrolluesi.

- Administroi me cilësi dhe provës në funksion të kontrollit administrativ, kontratë studimi, kontratë individuale e punës, Statutin e Universitetit dhe kontratën e Shërbimit me kompaninë që administron sistemin elektronik të Universitetit.

Kontrolluesi **“Universiteti Metropolitan Tirana”** gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë *“student”* dhe *“punonjës”*. Qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për kategorinë *“student”* është menaxhimi i aktivitetit universitar në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe edukimit, ndërsa për kategorinë *“punonjës”*, ndërtimi i marrëdhënieve të punës. Të dhënat personale të studentëve dhe punonjësve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mbledhen dhe përpunohen.

Për kategorinë *“student”* gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale si: *emri, mbiemri, gjinia, datëlindja, vendlindja, shtetësia, numri i kartës së identitetit, adresa e banimit, numri i telefonit, e-mail, kualifikimi arsimor, atësia, mëmësia, gjendja shëndetësore, fotografi.*

Këto të dhëna mbledhen nëpërmjet administrimit të Diplomave origjinale të shkollës së mesme, Çertifikatave të maturës shtetërore dhe fotokopjes së kartës së identitetit ose pasaportës. Gjithashtu të dhënat mbledhen përmes plotësimit të formularëve të aplikimit, kontratave të studimit, regjistrimit të matrikullës. Për secilin student kontrolluesi krijon një dosje personale, në të cilën mbledhet dokumentacioni shkresor, i paraqitur prej studentëve, dokumentacione këto të cilat mbartin të dhëna personale të tyre.

Për kategorinë *“punonjës”* kontrolluesi mbledh të dhëna personale si; *emri, mbiemri, data e lindjes, vendlindja, numrin e librezës së punës, gjendja civile, arsimi, raport mjekësor, kualifikime.* Këto të dhëna mbledhen gjatë procesit të marrjes në punë, për lidhjen e kontratës së punës dhe plotësimin e dosjes personale të punonjësit. Të dhënat administrohen në *“Dosjen personale të punonjësit”*, bazuar në legjislacionin e punës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson angazhimin e kontrolluesit **“Universiteti Metropolitan Tirana”**, për realizimin e detyrimit për njoftim brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e kontrollit administrativ, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka praktikë për të informuar studentët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar *“politikat e privatësisë”*, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen (të cilët mund të jenë edhe studentë) mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (studentëve) dhe detyrimet e kontrolluesit (Universiteti Metropolitan Tirana). Këto politika ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të studentëve e të punonjësve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale e realizon në mënyre manuale dhe elektronike nëpërmjet një sistemi të posaçëm i cili mirëmbahet nga një kompani private me të cilin ka një kontratë shërbimi. Sistemi informatik ka si qëllim menaxhimin e proceseve administrative. Ai aksesohet nëpërmjet një ndërfaqe "web", dhe baza e të dhënave ruhet në aplikacionin "SQL". Sistemi është i bazuar në 5 (pesë) nivele/profile përdorimi si: Administrator, Sekretari, Pedagog, Student, Prindër. Konstatohet se përdoruesit e sistemit kanë akses të kufizuar në bazë të profilit që bëjnë pjesë, dhe nuk mund të aksesojnë informacione të paautorizuara. Ambienti në të cilin është vendosur serveri ka akses të kufizuar. Kontrolluesi ka parashikuar një historik të veprimeve në sistem në mënyrë që të garantojë integritetin e të dhënave të studentëve.
- Dosjet me të dhëna personale mbahen në ambientet e sekretarisë dhe arshivës. Në këto ambiente aksesimi është i kufizuar vetëm për punonjësit e sekretarisë dhe Kancelarin e Universitetit. Janë marrë të gjitha masat për sigurinë fizike të ambienteve.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit.
- Kompania që mirëmban sistemin nuk ka akses në të dhënat personale të përdoruesve të sistemit (sipas profileve më sipër). Në kontratën e shërbimit parashikohet detyrimi i kompanisë që mirëmban sistemin për të ruajtur konfidencialitetin e informacioneve që akseson gjatë zbatimit të kontratës.
- Në kontratat individuale të punës me personelin e universitetit dhe pedagogët, në nenin 16, parashikohet se punëmarrësi nuk duhet të shpërndajë informacione konfidenciale të siguruara gjatë zbatimit të kontratës dhe detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit do të zgjasë edhe për periudhën një vit pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Në këtë kuadër Komisioneri vlerëson se detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk duhet të jetë i kufizuar në kohë por duhet të zgjasë për gjithë periudhën pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Kontrolluesi, mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të "video survejimit" (CCTV). Qëllimi i përdorimit të sistemit të "video survejimit" (CCTV) është sigurimi i ambienteve të kontrolluesit.

Në kuadër të përpunimit ligjor të të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-survejit (referuar Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi, në brendësi të godinës dhe ambientit të receptionit ka instaluar një kamera për të cilën përfaqësuesja e kontrolluesit deklaroi se është vendosur nga pronari i ndërtesës dhe nuk është aktive. Aksesimi në të është i kufizuar vetëm për administratorin.
- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit.

- Në ambientet e survejuara me kamera nuk ka tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit, kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar studentët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre.
2. Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (studentëve) dhe detyrimet e kontrolluesit (Universiteti Metropolitan Tirana) në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
3. Në zbatim të nenit 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë);
 - Personat që kanë akses në të dhënat personale të studentëve, ata që kanë akses në dosjet e dokumenteve të punonjësve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruara nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Në ambientet e survejuara me kamera të vendosen tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.
4. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;

5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

